

UDHËZIM
Nr. 8, datë 29.6.2012

**PËR KRITERET BAZË PËR NJOHJEN E LICENCAVE TË HUAJA TË PERSONELIT TË
MIRËMBAJTJES SË AVIONIT, NË LICENCË TË MIRËMBAJTËSIT AERONAUTIK**

Në përputhje me nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 7, pika “ç” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi

Përcaktimi i kriterëve bazë dhe procedurave për njohjen e licencave të huaja të personelit të mirëmbajtjes së avionit në licencë të mirëmbajtësit aeronautik

2. Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për personelin teknik të huaj të mirëmbajtjes, i cili punon në një organizatë shqiptare mirëmbajtjeje të miratuar, dhe zotëron:

- a) Licencë mirëmbajtësi aeronautik (LMA)-EASA nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian;
- b) Licenca të tjera jo nga shtetet të Bashkimit Europian.

3. Vlerësimi i licencave

Vlerësimi i licencave kryhet nga Autoriteti i Aviacionit Civil sipas rasteve:

- a) për personelin referuar nën pikës “a” të pikës 2, AAC-ja rivlerëson licencat EASA, duke i pajisur me certifikatë njohjeje për licencë mirëmbajtësi aeronautik;
- b) Për personelin referuar nën pikës “b” të pikës 2, Autoriteti i Aviacionit Civil nuk do të rivlerësojë në asnjë rast licenca të tilla.

4. Vlefshmëria e licencave

4.1 Licencat e rivlerësuara sipas nën pikës “a” të pikës 3 do të kenë vlefshmërinë njëvjeçare.

4.2 Ky proces do të jetë i vlefshëm deri në momentin që Republika e Shqipërisë do të bëhet anëtare me të drejta të plota në EASA.

5. Modeli i certifikatës

Në shtojcën bashkëlidhur, e cila është pjesë e këtij udhëzimi, paraqitet modeli standard i certifikatës së njohjes për licencë të mirëmbajtësit aeronautik - LMA.

6. Procedurat e konvertimit

Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për hartimin dhe nxjerrjen e procedurave përkatëse teknike për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Shfuqizime

Udhëzimi nr. 7, datë 29.3.2011 “Për procedurën e konvertimit të licencës kombëtare të personelit të mirëmbajtjes së avionit, në licencë të kufizuar të mirëmbajtësit aeronautik”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi